



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.639/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: kryesues, Ramush Bardiqi, Hidajete Gashi Alaj dhe Bujar Muzaqi, - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDAK-LPB, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 19.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.639/2025, e datës 17.03.2025, paraqitur nga koalicioni PDAK-LPB, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, me të cilën ka kërkuar që të anulohen 211 votat e partisë politike PAI të dërguara me postë ose të urdhërohet KQZ të rinumëroj këto vota, të anulohen 108 votat në Komuna që fare nuk ka banorë të komunitetit ashkalinje, të urdhërohet KQZ të rinumërojë votat në Shkollat Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci në Fushë Kosovë, dhe të urdhërohet KQZ ta përsëris votimin e diasporës.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 17.03.2025, ka pranuar ankesën Anr.639/2025, të parashtruar nga e koalicionit PDAK-LPB. Në të cilën pretendohet se nga rezultatet nga QKN të qasshme në databazën e KQZ, PDAK-LPB kishte marrur gjithsejtë 1977 vota apo 0.23 % krahas Partisë së Ashkalinjëve për Integrim (PAI) që kishte marrur 1821 vota apo 0.22%. Ndërkaq, në rezultatet përfundimtare ku ishin të përfshira edhe votat nga diaspora, PDAK-LPB del me 2056 vota apo 0.22 %, kurse PAI del me 2196 vota apo 0.23%. Këtë diferencë në mes të rezultateve preliminare dhe rezultateve përfundimtare, PDAK-LPB e konteston për arsyt si në vijim:

-Orkestrimi i votave” ku shihen qartë nga Provat e bashkëngiitura në këtë Ankesë, që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë.

-Votimi në grupacione nga Përfaqësues të PAI-së.

-Mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit, përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI.

Është pretendim i PDAK-LPB se subjekti politik PAI dhe anëtarët e saj kanë bërë "orkestrim të votave" duke ndikuar direkt tek votuesit, pretendim i cili mund të vërtetohet duke marrë për bazë fletëvotimet në KQZ të ardhura përmes postës.

Më tutje në ankesë theksohet se, në këto fletëvotime shihet qartë se aty janë votuar vetëm kandidatët Artan Asllani dhe Besart Jashari nga subjekti i PAI-së. PZAP mund të merr votat në Qendrën e Numërimit sipas vendvotimeve si: VP/06 Istog 3 vota; VP/08 Klinë 3 vota, VP/09 Fushë Kosovë 30 vota, VP/11 Mitrovicë e Jugut 4 vota, VP/13 Lipjan 12 vota, VP/15 Obiliq 4 vota, VP/17 Pejë 2 vota, VP/ 18 Podujevë 1 votë, VP/ 19 Prishtinë 3 vota, VP/20 Prizren 1 votë, VP/22 Shtime 6 vota, VP/25 Ferizaj 45 vota, VP/26 Viti 1 votë, VP/27 Vushtrri 4 vota.

Po ashtu në ankesë është theksuar se i PDAK-LPB, se edhe kandidati Etem Arifi me Nr. 1 i Listës Zgjedhore të të PAI ka organizuar "Orkestrim të votave" të qytetarëve që banojnë në Gjermani dhe të cilët kanë prejardhje nga qytetet e Kosovës Lipjan dhe Shtime. Votat janë orkestruar përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga Etem Arifi dhe votimi në grupacion. Etem Arifi ka kërkuar letërnjoftime në rrjete sociale për t'i regjistruar si votues dhe për të dëshmuar një gjë të tillë, shërben prova e videos bashkëngjitur me ankesë. VP/13 Lipjan 55 vota, VP/22 Shtime 26 vota, VP/25 Ferizaj 11 vota. Sipas parashtruesit të ankesës, PDAK-LPB, me këtë rast është dëmtuar nga procesi i votimit me postë nga diaspora sepse bazuar në provat e bashkëngjitura, tregohet qartazi se këtu kemi të bëjmë me manipulim të votuesit të diasporës duke u marrë letërnjoftimet e tyre dhe duke i regjistruar në paisjet e tyre, duke hapur e-mail për ta (gjë që i ka bërë pronar dëftesash) dhe duke i votuar votat e tyre pa dijeninë e tyre. E kjo padyshim që nuk mund të quhet ndryshe përveç se orkestrim votash. Tutje parashtruesi i ankesës ka kërkuar për anulimin e 108 votave në Komunën që fare nuk ka banorë të komunitetit ashkalinje e që përkundër këtij fakti janë paraqitur si votues në këto Komuna.

Pretendim ankimor i PDAK-LPB, është fakti se në komunat Killokot, Partesh, Ranillugë, Hani i Elezit, Junik, Malishevë, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpcë, Skenderaj, Novobërdë, Leposaviq, Kamenicë, Kaçanik, Dragash, Gjilan, Glllogovc, Deçan kanë votuar votues të komunitetit ashkalinje ndonëse në Regjistrimin e fundit të Agjensionit të Statistikave të Kosovës në këto komuna, nuk figuron ndonjë banor i komunitetit ashkalinje. Gjithashtu, parashtruesi i ankesës ka kërkuar ri-numërimin e votave në QKN, në shkollën Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci, në Fushë Kosovë, kjo për arsye se vëllai i kandidatit për deputet Artan Asllani është anëtar i KKZ në Fushë Kosovë (Agon Asllani) lehtë e verifikueshme nga PZAP. Më tutje, përmes ankesës ka kërkuar edhe përsëritjen e votimit të diasporës, kjo duke pasur parasysh faktin se në fletëvotimet e votuesve të komunitetit ashkalinje dhe dërgimi i tyre me postë ka pasur

parregullsi të detajuarash tashmë një pjesën e lartcekur të kësaj ankese. Dhe konsiderojmë se me këtë proces zgjedhor është cenuar e drejta e votimit ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë dhe Ligjin e aplikueshëm. Andaj, ka kërkuar nga PZAP, që pas shqyrtimit të ankesës, të marrë vendim me të cilin e aprovon si të bazuar ankesën e PDAK-LPB, të anulohen, 211 votat e partisë politike PAI të dërguara me postë ose të urdhërohet KQZ të rinumëroj këto vota, të anulohen 108 votat në Komuna që fare nuk ka banorë të komunitetit ashkalinj e që përkundër këtij fakti janë paraqitur si votues në këto Komuna, si dhe të urdhërohet KQZ të rinumërojë, votat në Shkollat Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci në Fushë Kosovë dhe të urdhërohet KQZ të përsërisë votimin e diasporës.

Provat në të cilat mbështetet kjo Ankesë janë: Video e Etem Afifi duke kërkuar letërnjoftimet për votuesit e diasporës; Video duke u votuar vetëm kandidatët Artan Asllani dhe Besart Jashari në grupacion në diasporë ku video është publikuar edhe në media; dëshmia e dëshmitares ku dëshmon se ju kanë marrë letërnjoftimet e gjithë familjarëve të tyre dhe janë manipuluar dhe orkestruar për vota. Audio-inqizimi me të cilin është përdorur letërnjoftimi personit dhe nuk e ka ditur për çfarë arsye e jep letërnjoftimin dhe nuk ka pasur fare email. Audio-inqizimi i një qytetare nga Gjermania me banim në Ferizaj ku tregon që kandidati Artan Asllani dhe Besart Jashari kanë shkuar në shtëpinë e saj në Gjermani dhe kanë vizituar disa familje dhe i kanë grumbulluar letërnjoftimet për t'i regjistruar si votues.

Në përgjigjen e KQZ-së, theksohet se lidhur me pretendimin ankimor se kishte "orkestrim të votimit", përmes procesit të regjistrimit, përkatësisht marrjes së dokumenteve dhe fletëregjistrimi, KQZ sqaron, Ligji nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), neni 97, paragrafi 1." Tutje në përgjigje në ankesë theksohet KQZ, me datën 23.07.2024, ka miratuar Rregulloren Nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës. Kjo Rregullore, ndër të tjera, përcakton mënyrën e regjistrimit për të votuar jashtë Kosovës, pranimin dhe evidentimin e dërgesave postare, procedimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të pranuar përmes postës dhe platformës elektronike, procesin e konfirmimit dhe kundërshtimit. Në nenin 3, paragrafi 3, përcaktohet: "kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet duke plotësuar dhe bashkëngjitur: 1, Të dhënat në formularin elektronik për regjistrim (duke përfshirë email adresën); 3,2, kopjen e njërit prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi; 3.3. verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit; 3,31. aplikuesi ngarkonfotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës; 3.32. nëse aplikimi bëhet përmes platformës elektronike shtetërore Ekosova, aplikuesi duhet të ketë kaluar verifikimin e dyfishtë të identitetit; 3.4. Në rast se dokumenti identifikues i lëshuar nga Republika e Kosovës është me afat të skaduar, duhet bashkëngjitur edhe një kopje e dokumentit të vlefshëm të identitetit të shtetit në të cilin jeton."

Përgjigje lidhur me pretendimin për anulimin e votave në komunat ku pretendohet se nuk ka votues të komunitetit ashkali. Sa i përket pretendimit ankimor ku ankuesi thekson se subjekti politik PAI ka marrë vota në qytetet ku nuk ka pjesëtar të komunitetit ashkali, KQZ sqaron: Lista e votuesve në Kosovë krijohet nga KQZ në bazë të të dhënave të Regjistrimit Civil të Republikës së Kosovës, i cili menaxhohet nga Agjencia e Regjistrimit Civil nën Ministrinë e Punëve të Brendshme. Procesi është i rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe përfshin disa hapa për të siguruar që lista të jetë sa më e saktë dhe gjithëpërfshirëse. Fillimisht, KQZ-ja merr të dhënat bazë nga Regjistri Civil, ku përfshihen emrat, mbiemrat, datat e lindjes dhe adresat e qytetarëve që kanë të drejtë vote (shtetas të Kosovës mbi 18 vjeç). Për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 9 shkurt 2025, u përdorën dy baza të dhënash: gjendja civile dhe të dhënat nga departamenti i prodhimit të dokumenteve, për të siguruar që asnjë qytetar me të drejtë vote të mos përjashtohet. Pas marrjes së këtyre të dhënave, KQZ-ja i përpunon ato dhe cakton votuesit në qendra votimi, duke u munduar që qytetarët të votojnë sa më afër vendbanimit. Neni 6 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) garanton të drejtën e secilit qytetar për të votuar, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës.

Përgjigje lidhur me pretendimin për rinumërimin e votave në tri qendra të votimit në komunën e Fushë Kosovës. KQZ sqaron se procesi i nominimit dhe emërimit të anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në komunën e Fushë Kosovës është realizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregulloren për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve. Gjatë këtij procesi nuk ka pasur kontestime apo ankesa të cilat do të mund të ndikojnë në ligjshmërinë e këtij procesi. Pa paragjykuar vlerësimin e mundshëm për konfliktin e interesit, çështje e cila është në kompetencë të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, KQZ thekson se as Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, as Rregullorja përkatëse, nuk parashikojnë kufizime të tilla që ndalonin një anëtar të KKZ-së të jetë familjar i kandidatit të subjektit politik. Edhe nëse një anëtar i KKZ-së ka një lidhje familjare me një kandidat, ai nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në procesin e numërimit të votave, pasi numërimi bëhet nga Ekipet e numërimit- Këshillat e Vendvotimeve (KË) në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe monitorohet nga vëzhgues të akredituar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli vlerëson se janë te pabazuara pretendimet ankimore për Orkestrimi i votave” ku shihen qartë nga Provat e bashkëngjitura në këtë Ankesë, që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, për arsye si ne vijim: Pretendimet e parashtruara në ankesë nga koalicioni PDAK-LPB, për anulimin e 211 votave të “orkestruara”, të votuesve me postë, anulimin e 108 votave në Komuna ku nuk ka fare banorë të komunitetit ashkalinje të cilët janë paraqitur si votues në këto Komuna dhe

pretendimi për ri-numërimin e votave në QKN, në shkollën Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci, në Fushë Kosovë, si dhe kërkesa për përsëritjen e votimit të diasporës, Paneli pasi shqyrtoj dhe i vlerësoi, provat e ofruara nga ankuesi të cilat gjenden në shkresa të lëndës, të njëjtat i refuzoj si të pabazuara, për arsye se, sipas procedurës, gjatë dhe pas procesit të regjistrimit për votim jashtë Kosovës është bërë verifikimi i aplikimeve të aprovuara me adrese e-mail, nëse mbiemrat e aplikuesve që kane ardhur nga e njëjta adrese e-mail kanë qenë të ndryshme, kontaktohen përmes telefonit për te verifikuar dhe siguruar që ata posedojnë dëftesën e regjistrimit. Gjate Komunikimit me telefon, kërkohen nga aplikuesit këto të dhëna, Emri dhe mbiemri, numri unik i dëftesës së regjistrimit. Andaj, mbi bazën e provave të prezantuara lidhur me këtë pretendim, Paneli nuk ka gjetur parregullsitë siç pretendohet në ankesë të ankuesit.

Paneli ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese për faktin se nuk mund të vërtetohet se votat me postë janë orkestruar përmes marrjes së letërnjoftimit, e-mailit dhe dëftesës, duke iu referuar edhe përgjigjes në ankesë nga ana e KQZ, shihet se procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës është zhvilluar në mënyrë të rregullt. Lidhur me pretendimin për anulimin e 108 votave në komunat ku pretendohet se nuk ka votues të komunitetit ashkalinje, janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se *“Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”*, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin tjetër të palës ankuese për rinumërimin e votave në tri qendra të votimit në komunën e Fushë Kosovës, të njëjtat janë të pabazuara, sepse edhe nga përgjigja në ankesë nga KQZ-ja, shihet se anëtarët e KKZ-së nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e numërimit të votave, pasi numërimi bëhet nga Ekipet e numërimit - Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), dhe monitorohet nga vëzhgues të akredituar.

Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore për Votime në grupacione nga Përfaqësues të PAI-së, këto pretendime janë të pabazuara për arsye se, në bazë të provave të prezantuara, video incizimeve dhe provave tjera nuk mund të identifikohet, dhe të vërtetohet fakti se këta persona janë pjesë e grupacioneve siç pretendon ankuesi.

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit, përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI, Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime të votave ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm deklaratime të pa mbështetura në prova, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe parregullsi si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në ankesë. PZAP vlerëson rregullativës Ligjore në fuqi për

Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Në rastin konkret, në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare, dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Paneli konsideron se nuk mund të pranohet një pretendim të tillë të shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Sa i përket pretendimit për anulimin e votave në komunat ku pretendohet se nuk ka votues të komunitetit ashkalinje, Paneli vlerësoj se, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe atyre të instrumenteve ndërkombëtare, se në rrethanat e rastit konkret në kuptim të nenit 45 të Kushtetutës të Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, të drejtën për të zgjedhur dhe për të tu zgjedhur, si për individët ashtu edhe për subjektet politike, në cilësi të personave juridikë, neni 45 i Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përfshin garancione përmbajtësore, siç është vota është personale, e lirë, e barabartë dhe e fshehtë, rrjedhimisht se as kandidatëve dhe as votuesve nuk duhet t'u kërkojë të tregojnë përkatësinë e tyre etnike.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 97, paragrafi 1, të Ligjit nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), parashihet se: "Shtetasi me të drejtë vote mund të aplikojë për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, duke dorëzuar të plotësuar formularin e aplikimit për regjistrim, nëpërmjet njëres nga këto mënyra: 1,1, përmes platformës elektronike, e cila garanton verifikimin e aplikuesit; 2. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe në rast të pamundësisë objektive për regjistrim, sipas platformës elektronike nga nën paragrafi 1.1 i këtij neni, KQZ mundëson regjistrimin si votues jashtë Kosovës edhe përmes e-mail-it personal, duke dërguar formularin dhe dokumentet e nevojshme në adresat elektronike të caktuara nga KQZ. KQZ nxjerr akt të veçante për përcaktimin e procedurave për aplikim, regjistrim dhe votim të shtetasve me të drejtë vote, që jetojnë jashtë vendit. Ndërsa neni 117 par. 3 të LZP-së, i cili përcakton se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e tij.

Përfundimisht, Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi

etnike të votuesit, as Ligji dhe as rregullativa e KQZ-së, nuk përcakton asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve.

Andaj Paneli refuzoi ankesën pasi që pala ankuuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetoj se votat për komunitetin ashkalinjë janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara në ligj, andaj ankesa u refuzua si e pa bazuara në kuptim të nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, dhe mbi këto arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 639/2025 më datën 19.03.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 **paragrafi 4 të LZP-së**, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



AA.nr.63/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare, Rrustem Thaqi dhe Lumni Sallauka anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, e parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), Anr.639/2025, të datës 19.03.2025, shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 24.03.2025, merr këtë:

AKT GJYKIM

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, e parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), Anr.639/2025, të datës 19.03.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), Anr.639/2025, të datës 19.03.2025, është vendosur: REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.639/2025, e datës 17.03.2025, paraqitur nga koalicioni PDAK-LPB, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09.02.2025, me të cilën ka kërkuar që të anulohen 211 votat e partisë politike PAI të dërguara me postë ose të urdhërohet KQZ të rinumëroj këto vota, të anulohen 108 votat në Komuna që fare nuk ka banorë të komunitetit ashkalinjë, të urdhërohet KQZ të rinumërojë votat në Shkollat Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci në Fushë Kosovë, dhe të urdhërohet KQZ ta përsëris votimin e diasporës.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Komuna Ferizaj, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që të: I. APROVOHET ankesa e parashtruar pranë kësaj gjykate më datë 21.03.2025, II. ANULOHET vendimi A.nr.639/2025 të PZAP-së të datës 19.03.2025 dhe të NDRYSHOHET vendimi Anr.639/2025, të datës



19.03.2025, ashtu që të: III. ANULOHEN 211 (dyqind e njëmbëdhjetë) votat e partisë politike Partinë e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), ose të urdhërohet KQZ të rinumërojë këto vota; IV. ANULOHEN, 108 votat në Komuna që fare nuk ka banorë të komunitetit ashkalinjë e që përkundër këtij fakti janë paraqitur si votues në këto Komuna; V. Urdhërohet KQZ të rinumërojë, votat në shkollat Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci në Fushë Kosovë; VI. Urdhërohet KQZ ta përsëris votimin e diasporës.


PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore duke shtuar se mbeten në tërësi pranë vendimit të kundërshtuar, i cili është në tërësi në pajtim me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe propozon që ankesa e subjektit politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.639/2025, të datës 19.03.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se më datë 17.03.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.631/2025, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, nr.01/727-2025, të datës 15.03.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025.

Në ankesën e ushtruar nga subjekti politik PDAK-LPB, theksohet se: PDAK-LPB konteston rezultatet përfundimtare për arsyet si në vijim: “Orkestrimi i votave” ku shihen qartë nga provat e bashkëngjitura në këtë ankesë, që janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, votimi në grupacione nga përfaqësues të PAI-së, mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit, përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI. Sipas ankuesit, subjekti politik PAI dhe anëtarët e saj kanë bërë “orkestrim të votave” duke ndikuar direkt tek votuesit, pretendim i cili mund të vërtetohet duke marrë për bazë fletëvotimet në KQZ të ardhura përmes postës. Këto fletëvotime shihen qartë se aty janë votuar vetëm kandidatët Artan Asllani dhe Besart Jashari nga subjekti i PAI-së. PZAP mund të merr votat në Qendrën e Numërimit sipas vendvotimeve si: VP/06 Istog 3 vota; VP/08 Klinë 3 vota, VP/09 Fushë Kosovë 30 vota, VP/11 Mitrovicë e Jugut 4 vota, VP/13 Lipjan 12 vota, VP/ 15 Obiliq 4 vota, VP/17 Pejë 2 vota, VP)/ 18 Podujevë 1 votë, VP)/ 19 Prishtinë 3 vota, VP)/20 Prizren votë, VP)/22 Shtime 6 vota, VP)/25 Ferizaj 45 vota, VP/26 Viti 1 votë, VP/27 Vushtri 4 vota. Po ashtu, kandidati Etem Arifi me Nr. 1 i Listës Zgjedhore të PAI ka organizuar “Orkestrim të votave” të qytetarëve që banojnë në Gjermani dhe të cilët kanë prejardhje nga qytetet e Kosovës Lipjan dhe Shtime. Votat janë orkestruar përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga Etem Arifi dhe votimi në grupacion. Etem Arifi ka kërkuar letërnjoftime në rrjete sociale për t'i regjistruar si votues dhe për të dëshmuar një gjë të tillë, shërben prova e videos bashkëngjitur me ankesë. VP/13 Lipjan 55 vota, VP)/22 Shtime 26 vota, VP)/25 Ferizaj 11 vota. Sipas parashtruesit të ankesës, PDAK-LPB, me këtë rast është



dëmtuar nga procesi i votimit me postë nga diaspora sepse bazuar në provat e bashkëngjitura, tregohet qartazi se këtu kemi të bëjmë me manipulim të votuesit të diasporës duke u marrë letërnjoftimet e tyre dhe duke i regjistruar në pajisjet e tyre, duke hapur e-mail për ta (gjë që i ka bërë pronar dëftesash) dhe duke i votuar votat e tyre pa dijeninë e tyre.

Tutje parashtruesi i ankesës ka kërkuar anulimin e 108 votave në Komunën që fare nuk ka banorë të komunitetit ashkalinjë e që përkundër këtij fakti janë paraqitur si votues në këto Komuna. Pretendim ankimor i PDAK-LPB, është fakti se në komunat Klllokot, Partesh, Ranillugë, Hani i Elezit, Junik, Malishevë, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpçë, Skenderaj, Novobërdë, Leposaviq, Kamenicë, Kaçanik, Dragash, Gjilan, Glllogovc, Deçan kanë votuar votues të komunitetit ashkalinjë ndonëse në regjistrimin e fundit të Agjensionit të Statistikave të Kosovës në këto komuna, nuk figuron ndonjë banor i komunitetit ashkalinjë. Gjithashtu, parashtruesi i ankesës ka kërkuar ri-numërimin e votave në QKN, në shkollën Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci, në Fushë Kosovë, kjo për arsye se vëllai i kandidatit për deputet Artan Asllani është anëtar i KKZ në Fushë Kosovë (Agon Asllani) lehtë e verifikueshme nga PZAP. Më tutje, përmes ankesës ka kërkuar edhe përsëritjen e votimit të diasporës, kjo duke pasur parasysh faktin se në fletëvotimet e votuesve të komunitetit ashkalinjë dhe dërgimi i tyre me postë ka pasur parregullsi të detajuara tashmë një pjesën e lartcekur të kësaj ankese. Dhe konsiderojmë se me këtë proces zgjedhor është cenuar e drejta e votimit ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë dhe Ligjin e aplikueshëm. Andaj, ka kërkuar nga PZAP, që pas shqyrtimit të ankesës, të marrë vendim me të cilin e aprovon si të bazuar ankesën e PDAK-LPB, të anulohen, 21 1 votat e partisë politike PAI të dërguara me postë ose të urdhërohet KQZ të rinumëroj këto vota, të anulohen 108 votat në Komuna që fare nuk ka banorë të komunitetit ashkalinjë e që përkundër këtij fakti janë paraqitur si votues në këto Komuna, si dhe të urdhërohet KQZ të rinumërojë, votat në Shkollat Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci në Fushë Kosovë dhe të urdhërohet KQZ të përsërisë votimin e diasporës.

Ankesës i ka bashkëngjitur edhe provat: Video e Etem Arifi duke kërkuar letërnjoftimet për votuesit e diasporës; Video duke u votuar vetëm kandidatët Artan Asllani dhe Besart Jashari në grupacion në diasporë ku video është publikuar edhe në media; dëshmia e dëshmitares ku dëshmon se ju kanë marrë letërnjoftimet e gjithë familjarëve të tyre dhe janë manipuluar dhe orkestruar për vota. Audio-inçizimi me të cilin është përdorur letërnjoftimi personit dhe nuk e ka ditur për çfarë arsye e jep letërnjoftimin dhe nuk ka pasur fare email. Audio-inçizimi i një qytetare nga Gjermania me banim në Ferizaj ku tregon që kandidati Artan Asllani dhe Besart Jashari kanë shkuar në shtëpinë e saj në Gjermani dhe kanë vizituar disa familje dhe i kanë grumbulluar letërnjoftimet për ti regjistruar si votues.

Më datë 19.03.2025, PZAP-i, njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.


Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 06.03.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: KQZ, me datën 23.07.2024, ka miratuar Rregulloren Nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, e cila ndër të tjera, përcakton mënyrën e regjistrimit



për të votuar jashtë Kosovës, pranimin dhe evidentimin e dërgesave postare, procedimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të pranuar përmes postës dhe platformës elektronike, procesin e konfirmimit dhe kundërshtimit. Në nenin 3, paragraf 3, përcaktohet: *“kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet duke plotësuar dhe bashkangjitur: 1. Të dhënat në formularin elektronik për regjistrim (duke përfshirë e-mail adresën); 3.2. kopjen e njërit prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi; 3.3. verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit; 3.31. aplikuesi ngarkon fotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës; 3.32. nëse aplikimi bëhet përmes platformës elektronike shtetërore E-kosova, aplikuesi duhet të ketë kaluar verifikimin e dyfishtë të identitetit; 3.4. Në rast se dokumenti identifikues i lëshuar nga Republika e Kosovës është me afat të skaduar, duhet bashkëngjitur edhe një kopje e dokumentit të vlefshëm të identitetit të shtetit në të cilin jeton”*.

Sa i përket pretendimit ankimor ku ankuesi thekson se subjekti politik PAI ka marrë vota në qytetet ku nuk ka pjesëtar të komunitetit ashkali, KQZ sqaron se lista e votuesve në Kosovë krijohet nga KQZ në bazë të të dhënave të Regjistrimit Civil të Republikës së Kosovës, i cili menaxhohet nga Agjencia e Regjistrimit Civil nën Ministrinë e Punëve të Brendshme. Procesi është i rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe përfshin disa hapa për të siguruar që lista të jetë sa më e saktë dhe gjithëpërfshirëse. Fillimisht, KQZ-ja merr të dhënat bazë nga Regjistri Civil, ku përfshihen emrat, mbiemrat, datat e lindjes dhe adresat e qytetarëve që kanë të drejtë vote (shtetas të Kosovës mbi 18 vjeç). Për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 9 shkurt 2025, u përdorën dy baza të dhënash: gjendja civile dhe të dhënat nga departamenti i prodhimit të dokumenteve, për të siguruar që asnjë qytetar me të drejtë vote të mos përjashtohet. Pas marrjes së këtyre të dhënave, KQZ-ja i përpunon ato dhe cakton votuesit në qendra votimi, duke u munduar që qytetarët të votojnë sa më afër vendbanimit. Neni 6 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) garanton të drejtën e secilit qytetar për të votuar, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës. Tutje, KQZ sqaron se procesi i nominimit dhe emërimit të anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në komunën e Fushë Kosovës është realizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregulloren për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve. Gjatë këtij procesi nuk ka pasur kontestime apo ankesa të cilat do të mund të ndikojnë në ligjshmërinë e këtij procesi. Pa paragjykuar vlerësimin e mundshëm për konfliktin e interesit, çështje e cila është në kompetencë të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, KQZ thekson se as Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, as Rregullorja përkatëse, nuk parashikojnë kufizime të tilla që ndalonin një anëtar të KKZ-së të jetë familjar i kandidatit të subjektit politik. Edhe nëse një anëtar i KKZ-së ka një lidhje familjare me një kandidat, ai nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në procesin e numërimit të votave, pasi numërimi bëhet nga Ekipet e numërimit-Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe monitorohet nga vëzhgues të akredituar.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se ankesa është e pabazuar.



PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Pretendimet e parashtruara në ankesë nga koalicioni PDAK-LPB, për anulimin e 211 votave të “orkestruara”, të votuesve me postë, anulimin e 108 votave në Komuna ku nuk ka fare banorë të komunitetit ashkalinjë të cilët janë paraqitur si votues në këto Komuna dhe pretendimi për ri-numërimin e votave në QKN, në shkollën Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci, në Fushë Kosovë, si dhe kërkesa për përsëritjen e votimit të diasporës, paneli të njëjtat i refuzoj si të pabazuara, për arsye se, sipas procedurës, gjatë dhe pas procesit të regjistrimit për votim jashtë Kosovës është bërë verifikimi i aplikimeve të aprovuara me adresë e-mail, nëse mbiemrat e aplikuesve kanë ardhur nga e njëjta adresë e-mail kanë qenë të ndryshme, kontaktohen përmes telefonit për të verifikuar dhe siguruar që ata posedojnë dëftesën e regjistrimit. Gjatë komunikimit me telefon, kërkohen nga aplikuesit këto të dhëna: *Emri dhe mbiemri, numri unik i dëftesës së regjistrimit*. Andaj, mbi bazën e provave të prezantuara lidhur me këtë pretendim, paneli nuk ka gjetur parregullsitë siç pretendohet në ankesë të ankuesit. Paneli ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese për faktin se nuk mund të vërtetohet se votat me postë janë orkestruar përmes marrjes së letërnjoftimit, e-mailit dhe dëftesës, duke iu referuar edhe përgjigjes në ankesë nga ana e KQZ, shihet se procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës është zhvilluar në mënyrë të rregullt. Lidhur me pretendimin për anulimin e 108 votave në komunat ku pretendohet se nuk ka votues të komunitetit ashkalinjë, janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 të LZP-së, që parasheh se *“Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”*, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar. Ndërsa lidhur me pretendimin tjetër të palës ankuese për rinumërimin e votave në tri qendra të votimit në komunën e Fushë Kosovës, të njëjtat janë të pabazuara, sepse edhe nga përgjigja në ankesë nga KQZ-ja, shihet se anëtarët e KKZ-së nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e numërimit të votave, pasi numërimi bëhet nga Ekipet e numërimit - Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), dhe monitorohet nga vëzhgues të akredituar. Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore për votime në grupacione nga përfaqësues të PAI-së, këto pretendime janë të pabazuara për arsye se, në bazë të provave të prezantuara, video incizimeve dhe provave tjera nuk mund të identifikohet, dhe të vërtetohet fakti se këta persona janë pjesë e grupacioneve siç pretendon ankuesi. Në vazhdim ka shtuar se: sa i përket pretendimit ankimor lidhur me mosrespektimi i vullnetit të qytetarit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit, përmes marrjes së letërnjoftimit, hapjes së e-mailit dhe dëftesës nga PAI, Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragraf 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime të votave ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm deklarime të pa mbështetura në prova, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe parregullsi si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në ankesë.

PZAP pasi ka vlerësuar rregullativën ligjore në fuqi për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, ka konstatuar se: Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Në rastin konkret, në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën



e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare, dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Paneli konsideron se nuk mund të pranohet një pretendim të tillë të shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime. Sa i përket pretendimit për anulimin e votave në komunat ku pretendohet se nuk ka votues të komunitetit ashkalinjë, Paneli vlerësoj se, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe atyre të instrumenteve ndërkombëtare, se në rrethanat e rastit konkret në kuptim të nenit 45 të Kushtetutës të Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, të drejtën për të zgjedhur dhe për të tu zgjedhur, si për individët ashtu edhe për subjektet politike, në cilësi të personave juridikë, neni 45 i Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së përfshin garancione përmbajtësore, siç është vota është personale, e lirë, e barabartë dhe e fshehtë, rrjedhimisht se as kandidatëve dhe as votuesve nuk duhet t'u kërkojë të tregojnë përkatësinë e tyre etnike.

Paneli vendosjen e mbështet në nenin 97, paragrafi 1, të Ligji nr.08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), parasheh se: *“Shtetasi me të drejtë vote mund të aplikojë për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, duke dorëzuar të plotësuar formularin e aplikimit për regjistrim, nëpërmjet njëres nga këto mënyra: 1,1, përmes platformës elektronike, e cila garanton verifikimin e aplikuesit; 2. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe në rast të pamundësisë objektive për regjistrim, sipas platformës elektronike nga nën paragrafi 1.1 i këtij neni, KQZ mundëson regjistrimin si votues jashtë Kosovës edhe përmes e-mail-it personal, duke dërguar formularin dhe dokumentet e nevojshme në adresat elektronike të caktuara nga KQZ. KQZ nxjerr akt të veçantë për përcaktimin e procedurave për aplikim, regjistrim dhe votim të shtetasve me të drejtë vote, që jetojnë jashtë vendit. Ndërsa neni 117 par. 3 të LZP-së, i cili përcakton se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e tij”.*

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, as ligji dhe as rregullativa e KQZ-së, nuk përcakton asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve. Andaj Paneli refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetojë se votat për komunitetin ashkalinjë janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara. Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara




në ligji, andaj ankesa u refuzua si e pa bazuar në kuptim të nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, dhe mbi këto arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 17.03.2025, të parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK) - LPB, me seli në Ferizaj, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 97 paragraf 1, 2 dhe 3, neni 6 par 1 dhe 2 dhe 72 par.1 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe neni 3 paragraf 3, 3.2, 3.3, 3.3.1, 3.3.2, 3.4 të Rregullores nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës si dhe neni 16 të Rregullores nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.

Duke vepruar sipas ankesës së subjektit politik PDAK-LPB, dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kolegji i kësaj gjykate vlerësoj se pretendimet kryesore të ankuesit i referohen: i) anulimit të 211 votave të “orkestruara” të votuesve me postë, ii) anulimit të 108 votave në komunën e cila nuk ka fare banorë të komunitetit ashkalinjë, iii) ri-numërimit të votave në QKN-në shkollën Mihal Grameno, Selman Riza dhe Daut Bogujevci në Fushë Kosovë dhe iv) përsëritjen e votimit të diasporës. Pretendime këto të cilat subjekti politik ankues i ka arsyetuar siç vijon: në qendrat e numërimit, janë votuar vetëm dy ose tre kandidatë, ka pasur votim në grupacione dhe mosrespektim të vullnetit të qytetarëve, ndikim tek votuesit, përdorimi i njëjtë i numrit të letërnjoftimit dhe i email-it, po ashtu kanë votuar votues edhe në komunat ku nuk ka banorë ashkalinjë, konfliktit të interesit, përkatësisht lidhjen familjare të anëtarit të të KKZ-së në Fushë Kosovë, Agon Asllani, me kandidatin për deputet Artan Asllani etj.

Pretendimet ankimore të lartcekura, të theksuar dhe elaboruara më gjerësisht edhe në ankesë, kolegji i kësaj gjykate i ka shqyrtuar me vëmendje dhe kujdes të veçantë, megjithatë të njëjtat i ka refuzuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për faktin se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura ligjore si dhe ankuesi të njëjtat pretendime ankimore i ka parashtruar edhe pranë PZAP-së, me ç’rast edhe arsyetimi i tyre është konsumuar me vendimin e atakuar. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, përcaktuese për ligjshmërinë e vendimit të PZAP-së, është fakti se ankuesi ka parashtruar pretendime të paprovuara për manipulimin dhe orkestrimin e votave. Gjykata, nuk ka mundur që me asnjërin nga provat e ofruara nga ankuesi, të vërtetojë pretendimet ankimore lidhur me cenimin e të drejtës së votimit, apo shkeljes së nenit 6 dhe 10 paragraf 1 të LZP-së, neni 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç thekson ankuesi në ankesën e tij. Ndërsa provat e parashtruara, janë të pathemelta sepse çdo pretendim për manipulim apo orkestrim të votave duhet të provohet në masë të besueshme për të krijuar bazë për rinumërim, anulim apo përsëritje të rinumërimit, apo edhe për një vendim tjetër, prandaj në këtë rast këto pretendime janë pa ndikim për të vendosur ndryshe. Provat e bashkëngjitura në ankesë, nuk provojnë në mënyrë



të besueshme manipulimin e rezultatit të subjektit politik PAI apo/dhe kandidatëve të saj, dhe nuk përbën shkak për të urdhëruar ri-numërimin në vendvotimet e pretenduara.


Gjykata, në shqyrtimin e ankesës, ka vlerësuar pretendimet lidhur me votat e votuesve jashtë Kosovës, ku ankuesi ka pretenduar se ka pasur manipulime dhe orkestrime të regjistrimit të votuesve përmes platformës elektronike, duke kërkuar anulimin e votave të regjistruara nga KQZ. Gjykata ka konstatuar se KQZ ka zbatuar procedurat ligjore dhe ka siguruar një nivel të lartë të verifikimit të aplikimeve. Provat që janë paraqitur nga ankuesi nuk kanë arritur të dëshmojnë në mënyrë të mjaftueshme se ka pasur manipulime përgjatë procesit. Po ashtu, nuk është vërtetuar se ndonjë nga anëtarët e ekipeve të numërimit në QKN apo vëzhgues, që kanë verifikuar aplikimet apo vëzhguar procesin, kanë kryer apo evidentuar ndonjë shkelje të rregullave të përcaktuara. Gjykata ka shqyrtuar kërkesën për anulimin e 211 votave të subjekteve të PAI-së, dhe ka vlerësuar se nuk ka prova të mjaftueshme që të mund të provojnë se këto vota janë dhënë nga individë të paautorizuar ose janë manipuluar në mënyrë të jashtëligjshme. Gjykata ka arsyetuar se çdo votë që është regjistruar në përputhje me procedurat dhe ligjet e parashikuara nuk mund të anulohet thjesht mbi bazën e pretendimeve të paqëndrueshme. Një tjetër aspekt i ankesës ka të bëjë me votat e votuesve në Komuna ku sipas ankuesit, nuk ka banorë të komunitetit ashkalinjë. Gjykata, duke analizuar këtë pretendim, ka gjetur se rregullat e regjistrimit janë respektuar dhe procesi i verifikimit i KQZ-së ka siguruar që çdo aplikim të jetë i ligjshëm dhe i bazuar në informacione të përcaktuara ligjor.

Në këtë çështje, ankuesi ka paraqitur disa prova, përfshirë videot dhe audio-incizimet, duke pretenduar se ato dëshmojnë orkestrimin e votave. Megjithatë, Gjykata ka shqyrtuar këto prova dhe ka arritur në përfundimin se ato nuk janë të mjaftueshme për të konfirmuar manipulimin apo orkestrimin e votimit apo individët përgjegjës për ndonjë veprim të jashtëligjshëm gjatë regjistrimit të votuesve. Dëshmitë e ofruara, edhe pse sugjerojnë mundësinë e manipulimeve, nuk përmbajnë informacione të mjaftueshme dhe të qarta që mund të provojnë se procesi i regjistrimit dhe i votimit ka ndodhur në mënyrë të paligjshme.

Gjykata ka vlerësuar se, përveç rregullave të veçanta për procesin zgjedhor, është e rëndësishme të respektohen parimet kushtetuese dhe të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtën e qytetarëve për të votuar. Në këtë kontekst, edhe pse ka pasur disa pretendime për shkelje të mundshme, nuk është provuar se procesi zgjedhor ka ndodhur në mënyrë të paligjshme ose që ka cenuar të drejtat e qytetarëve për të ushtruar votën e tyre.

Në këtë kontekst Gjykata Supreme e pranon në tërësi arsyetimin e dhënë nga PZAP, lidhur me mungesën e provave për të bazuar pretendimet e parashtruara dhe lidhur me referencat ligjore për bazën e refuzimit të apelit të parashtruar në PZAP, në këtë rast me referencë në nenin 117 par. 3 dhe 118 par.1 të LZP-së

Nga këtu ankuesi, me pretendimet ankimore, me asnjë provë nuk ka arritur që të vë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë nga ana e organit vendimi i të cilit është kontestuar, andaj si të pa bazuara i ka vlerësuar pretendimet e ankuesit në ankesë, përkritazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.63/2025 me 24 mars 2025

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
